



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhevdet Bushi, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 30 244 111 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot. 1/977  
Date: 21.6.2024

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbajtje më datë 13.6.2024, merr këtë:

### V E N D I M

- I. **JEPET PËLQIMI** – për dhënie në shfrytëzim të objektit të Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore, Departamenti i Kimisë për nevojat e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe të Sportit.
- II. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, do të marr në shfrytëzim objektin e Departamentit të Kimisë, pas zhvendosjes së Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore në objektin të ri.
- III. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

### A r s y e t i m

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 13.6.2024, ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar në formë elektronike më 11.6.2024, nga dekani i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe i Sportit, prof. asoc. dr. Musa Selimi, për marrjen në shfrytëzim të objektit të Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore, Departamenti i Kimisë.

Projekti i ndërtimit të objektit të ri të Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore pritet të përmbyllet në muajin maj të vitit 2025 dhe pritet të jetë i gatshëm për shfrytëzim më së largu deri në fillimin e vitit akademik 2025/26.

Këshilli Drejtues, e konsideroi të arsyeshme kërkesën e dekani të FEFS-it dhe dha pëlqimin për shfrytëzimin e objektit i cili shfrytëzohet për nevojat e Departamentit të Kimisë, me rastin e funksionalizimit të objektit të ri dhe zhvendosjes së Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore.

Duke marrë parasysh atë çfarë u tha më lart, KD vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

  
Këshilli Drejtues i UP-së  
Arta Sahiti - kryesues

### Vendimi t'u dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Këshillit Drejtues,
3. Dekanëve të njësive akademike,
4. Sekretarëve të njësive akademike,
5. Zyrës ligjore,
6. Asistentes së KD-së.